

# Florian Vlasi, ndër 100 personalitetet shqiptare në Perëndim



*Mendoj se 100 personazhe janë pak. Ka shumë e shumë të tjerë që punojnë në Perëndim dhe që nderojnë Shqipërinë në heshtje, pa zhurmë, pa bujë, duke ulur kokën e duke punuar nga mëngjesi deri në mbrëmje qoftë në një teatër, në fabrikë apo në një furrë buke. Intuuta më thotë se shumica e shqiptarëve kanë diçka nga “sindroma e Skënderbeut” - mbrojnë kështjellën nga jashtë.*

Me rastin e 100 vjetorit të pavarësisë organizata jofitimprurëse Albanian Excellence është duke përzgjedhur 100 shqiptarët, që duke jetuar jashtë vendit, kanë krijuar atje një reputacion brilant, falë aftësive profesionale të dëshmuara atje. Figurat e përzgjedhura janë nga të gjitha fushat e jetës, duke përfshirë këtu dhe artin, fushë ku Shqipëria ka nxjerrë gjithnjë personalitete që na kanë nderuar në skenat botërore. Në mes të artistëve të përzgjedhur nga kjo organizatë na ra në sy emri i violinistit të talentuar durrsak Florian Vlasi. Duke e uruar Florianin për këtë arritje që i shtohet kurrikulimit të tij mjaft të pasur artistik po botojmë me shkurtime intervistën e publikuar në profilin e Vlashit, në website-n e kësaj organizate. Intervistën e plotë mund ta lexoni në: <http://www.albanianexcellence.com/pages/FlorianVlasi>

**Ju jeni nga viti 1992 pjesë shumë e rëndësishme e Orkestrës Sinfonike të Galicisë, është një rrugëtim i gjatë ...**

Sigurisht, megjithatë për mua ishte një lëvizje e natyrshme, pa trauma. Ishte si një bindje e një urdhri të vjetër që ka të bëjë me racën e instrumentistëve, me rrugëtimet e tyre që, në një revistë spanjolle, e kam quajtur si rrugëtimi i trubadurëve.

## **Një violinë thonë që nuk është një objekt ... është një qenie. A dini ta perkufizoni karakterin e saj?**

Jo, nuk është e thjeshtë... Sa më shumë që e kërkon përgjigjen aq më shumë i largohesh të vërtetës. E tërë historia e saj nga krijimi e deri më sot është e rrethuar me një vel misteri. Është më mirë ta lesh kështu, të papërcaktuar, në magjinë e vet.

## **Cila ka qënë violina juaj e parë dhe ajo e fundit?**

Violina e parë duhet të ketë qënë një instrument çekoslovak që na jepte shkolla e muzikës. Ishin instrumenta me të cilët punohej shumë. Për këtë arsye ishin të dëmtuar, të gërvishur, në disa raste të thyer e plot shenja dhune. Por, për çudi, tingëllonin mirë. Ndërsa violina e fundit është një instrument francez i mrekullueshëm i shekullit XVIII të cilën ma dhuroi kompozitorja spanjolle Maria Dolores Malumbres pas koncertit tim në Logroño. Është një histori prekëse që mendoja se ndodhnin vetëm nëpër libra. Aktualisht përdor një tjetër instrument francez të 1700 nga Jacques Boquay, nga të parët që futën liuterine italiane në Francë. E bleva tek koleksionistet e Rue de Romewne në Paris. “Musée de la musique” në Francë ka dy violina nga Boquay në koleksionin e saj.

## **Në pergjithësi keni shkuar ju te repertori që interpretoni apo ka ardhur ai tek ju?**

Në fillim kam shkuar unë tek ai. Tani vjen ai tek unë. Gjithmonë më ka tërhequr arti modern e për pasojë muzika moderne bashkëkohore dhe i jam afruar asaj me kërshëri siç i afroresh një aventure, rrezikut, të panjohurës...Por tani shkruhet shumë muzikë për mua dhe për GISXX që drejtoj sa që më krijon një gjendje paniku se a do t'ja dal mbanë apo jo. Në dy koncertet që kam tani së afërmi do të luajmë 12 vepra premierë të kompozitorëve spanjolle.

## **Shumë herë jeni konsideruar një fenomen muzikor nga media spanjolle...**

Më duket vlerësim i tepruar që, natyrisht, nuk e meritoj aspak. Mua më pëlqen të ndjek këshillën e Churchill-it që thotë se problemi i kohës sonë është se njerëzit duan të jenë të rëndësishëm dhe jo të nevojshëm. Kur kompozitori dhe Presidenti i ACG (Asociación de los Compositores de Galicia) Paulino Pereiro më dedikoi Sonata para violín solo op. 118 me titullin Vlashiana, u gëzova pa masë. Por kur deklaroi se “...ja dedikoj një personi pa të cilin muzika e re në Galicia nuk do të ishte ajo që është...” u ndjeva vërtet i lumtur sepse kam përmbushur një detyrim moral ndaj muzikës dhe kompozitorëve të këtij vendi. Ky nuk është kurrfarë fenomeni. Është një shërbim, një bashkëpunim i domosdoshëm ndërmjet krijuesit dhe interpretit. Një lidhje e vjetër kjo sa vetë muzika.

## **Pse ndiheni të lidhur pas muzikës shqiptare, çfarë ka të veçantë dhe çfarë ju jep?**

Ndjehem i lidhur me muzikën shqiptare sepse jam i lidhur me vendin tim. Ajo është pjesë esenciale e tij. Është si parfumi që të kujton një person të dashur mungesën e të cilit e ndjen

përditë e më shumë. Megjithatë jam përpjekur të tregohem realist duke lënë me një anë nostalgjinë dhe të përzgjedh me kujdes veprat shqiptare që luaj në Spanjë. Janë pritur mjaft mirë. Publiku, duke dëgjuar këtë muzikë, ka njohur dhe ka kuptuar diçka më shumë për realitetin shqiptar. Më kujtohet, kur luajta Trion “Vikamë” të Feim Ibrahimit, një vepër mjeshtërore e muzikës shqiptare, po i shpjegoja me pak fjalë publikut diçka mbi autorin dhe pjesën. Në një moment mbeta: si mund t’u shpjegoja fjalën “vikamë” që nuk ekziston në spanjisht. El grito? Më afër është Skrik në norvegjisht, sepse përjetësoi një nga veprat ikonë të artit modern “Ulërima” e Edvard Munch. Atëhere u përpoqa ta shpjegoj duke e interpretuar atë; universi ekzistencialist i “vikamës” së Feimit është shumë më afër meje se sa “ulërima” e njeriut pa seks nga kodrat e Oslos.

### **Në vitin 1999, ju keni mbështetur luftën në Kosovë... bile ju edhe të ardhurat që keni nxjerrë nga një CD e juaja ia keni dërguar popullit të Kosovës. Disa kujtime tuajat nga ajo kohë? Cilat janë marrëdhëniet tuaja tani me Kosovën?**

Gjatë luftës së Kosovës, nuk e di pse, u ndodha papritur nën fokusin e mediave spanjolle. Ato kohë dhashë shumë intervista në shtyp e TV si dhe bëra një debat televiziv me futbollistin Mijatoviç në Canal+. Kur shkova në verë në Durrës vizitova kampet e refugjatëve dhe spitalin që kishte ndërtuar Kryqi i Kuq spanjoll dhe u preka shumë. Pas kthimit në Spanjë kalova të ardhurat e CD time në Ilogarinë e Kryqit të Kuq. Nuk ishte asgjë më shumë se një xhest falenderimi dhe mirënjohje. Në Kosovë kam luajtur disa herë i ftuar nga Remusica. Në këto raste njoha nga afër muzikën e kompozitorëve kosovarë dhe mbeta i befusuar për nivelin e lartë. Singerisht, më erdhi turp që e kisha njohur aq pak deri tani. Në edicionin në vazhdim të Bienales së Durrësit “Netët e Muzikës Klasike” krijuam menjëherë një hapësirë të quajtur “Nata e Muzikës Kosovare” ku kompozitorët bashkohës të Kosovës prezantuan krijimet më të fundit. Kompozitori Rafet Rudi bëri një panoramë të plotë të kësaj muzike. Në fund, profesor Akil Koçi gjatë falenderimit tha se ishte e para herë që bëhej një gjë e tillë në Shqipëri në këto... 60 vjet. Nuk e di nëse më gëzoi apo më trishtoi ky fakt...

### **Shumë syresh ju kanë përcaktuar si përçues të kulturës shqiptare në Spanjë?**

Nuk e di... Besoj tek arti shqiptar dhe tek ai i vendeve që nuk e kanë historinë e mërzitshme. Më vjen ndër mend filmi “Njeriu i tretë” i Orson Welles ku thotë diçka mbi Italinë e Borgia-ve plot luftëra, terror dhe vdekje por që nxorren një Mikel Anxhelo e një Leonardo da Vinçi. Ndërsa nga Zvicra me 500 vjet demokraci e paqe çfarë kemi? Vetëm orët me kuku.

### **Çfarë ju kanë dhënë studimet e para për muzikë në shkollën “Jan Kukuzeli”?**

Aty kam pasur kontaktin e parë me violinën, me notat, me gërmat... Profesorin tim të parë të violinës e arrestuan dhe vdiq në burg. Ky ishte kontakti im i parë me diktaturën. Akoma e kujtoj ditën që e pashë për herë të fundit duke u futur në sallën e gjyqit. Nuk i fola... dhe kjo gjë më ka mbetur si një gur brenda meje edhe sot e kësaj dite... Një mikja ime nga Shkodra, studente për drejtësi në Stockholm, më shkruan në një letër se nuk ishte bërë violiniste, me gjithë dëshirën e saj, sepse ndërmjet shtëpisë ku banonte dhe shkollës së muzikës së qytetit, ishte një rrugë plot rreziqe ku kalonin shumë makina. Edhe shtëpinë time me shkollën e muzikës e ndante një rrugë e tillë. Dhe une e kapërceja përditë me violinën në dorë. Me sa duket çdo gjë fillon duke

kapërcyer një rrugë e vazhdon duke kapërcyer stacione, aeroporte, shtete e kështu deri në udhëtimin e fundit që të kthen tek rruga e parë. Për çudi, karriera e një muzikanti ka formën e sonatës.

## **Besoj se një nga projektet tuaja të dashura është festivali “Netët e Muzikës Klasike” që drejton në Durrës nga viti 2003. Si lindi kjo iniciativë dhe në çfarë niveli ka arritur deri tani?**

Ndrysha nga GISXX, projekti i bienales së Durrësit është me “familjar”, më intim. Mblidhemi ndërmjet miqsh për të bërë muzikë bashkë për të luajtur për një publik ku njihemi të gjithë. Nuk ka gjë më të bukur. Në fund të fundit, kjo është esenca e muzikës së dhomës. Mbi këtë natyrshmëri është ngritur edhe ngrehina e bienales. Jane shtatë netë të dedikuara një tematike dhe një periudhë muzikore: Nata e Muzikës Baroke, Klasike, Romantike, Moderne, Shqiptare, Konkursi Yjet e Rinj dhe Carte Blanche. Çdo koncert shfaqet në ambjente të ndryshme të qytetit si: Katedralja Shën Luçia, Muzeu Arkeologjik, Jozef Gallery, Teatri “Aleksander Moisiu”, Shkolla e muzikës “Jan Kukuzeli” e deri tek një fabrikë e braktisur në rrethinat e qytetit...Janë luajtur vepra madhore të historisë së muzikës, disa prej të cilave vinin për herë të parë në Shqipëri si “Arti i Fuges” i Bahut apo “Historia e ushtarit” e Straviskit. Për çdo edicion porositet një vepër e shkruar enkas për bienalen ndërsa, fituesi i konkursit të të rinjve, ftohet në Spanjë për disa koncerte. Në koncertet e kaluara, “Natën e barokut venecian”, ja dedikuam Kontit Giacomo Durazzo, një figurë e madhe e kulturës europiane i cili gjatë kohës së qëndrimit në Venedik, si Ambasador, mblodhi dhe koleksionoi pjesën më të madhe të dorëshkrimeve të Vivaldit përfshi këtu edhe “Katër Stinët”. Këto dorëshkrime panë dritën vetëm në vitet 20 të sh. XX. Durrësi, Torra veneciane, Vivaldi, konti Durazzo, instrumentistë durrsakë, violina të 1700...krijojnë një kuadër të bukur, një “kolazh” emocionues. E gjitha kjo është një rikthim për mua; një rikthim në qytetin tim, në fëmijërinë time dhe, në të njëjtën kohë, një mbyllje e “rrethit” ku çdo gjë merr kuptim. Kjo nostalgji e bën më prekëse muzikën.

## **A kemi pika të përbashkëta ne shqiptarët me spanjollët?**

Mendoj se po. Jemi dy popuj jugorë të Europës me shumë gjëra të përbashkëta si të gjithë mesdhetarët. Me sa kam lexuar, kontaktet e para të spanjollëve me shqiptarët nuk janë dhe aq për t’u krenuar: Autori i Don Kishotit, Cervantes, ka qënë rob i një anije piratësh ku kapiteni ishte shqiptar. Quhej Arnaut Mami. Mbase njohja me Shqiptar Mamin të jetë edhe zanafilla e krijimit të figurës së Don Kishotit. Nuk e di, por donkishotizmi ka diçka në karakterin tonë dhe këtë nuk e them me kuptimin fyes, sepse kalorësi i Mançes nuk ishte i keq, as i marrë. Përkundrazi. Veçse luftonte kundër mullinjve të erës... A ju kujton kjo diçka? Nëse jo, aty janë librat e Nolit e Konicës. Aty janë librat e historisë.

## **Ju jeni ndër të paktët shqiptarë që mbani një lidhje kaq të ngushtë me vendin tuaj. Si e shihni Shqipërinë në 100 vjetorin e shtetit të saj?**

E shoh më shumë dritë-hije. Ka ende shumë për të bërë nga të gjithë ne. Sipas Fishtës, Zoti nuk e ka braktisur kurrë Shqipërinë por, për fat të keq, ...as Djalli. Mendoj se ai vend meriton një fat më të mirë.

## **Mendoni se do të jeni të pranishëm në kremtimet e Pavarësisë?**

Jam duke punuar mbi tre projekte rreth këtij evenimenti. Janë tre koncerte - në Madrid, La Coruña dhe Bruksel.

## **Mendimi juaj për këtë iniciativë të AE-së?**

Më duket një projekt i mrekullueshëm dhe i nevojshëm. Ndjelesh shumë mirë kur të vlerësojnë në vendin tënd. Ne që jetojmë e punojmë jashtë e ndjejmë veten të huaj dy herë: një herë kur ikim dhe një herë kur kthehemi. Kur ikim, sepse shkojmë në një vend tjetër, në një realitet ndryshe. Kur kthehemi, sepse as ne nuk jemi ato që ishim dhe as vendi ai që lamë. Iniciativa e AE-së e bën më të lehtë pjesën e dytë. Mendoj se 100 personazhe janë pak. Ka shumë e shumë të tjerë që punojnë në Perëndim dhe që nderojnë Shqipërinë në heshtje, pa zhurmë, pa bujë, duke ulur kokën e duke punuar nga mëngjesi deri në mbrëmje qoftë në një teatër, në fabrikë apo në një furrë buke. Intuita më thotë se shumica e shqiptarëve kanë diçka nga “sindroma e Skënderbeut” - mbrojnë kështjellën nga jashtë.

- See more at: <http://www.durreslajm.com/kultura/florian-vlashi-nd%C3%ABr-100-personalitetet-shqiptare-n%C3%AB-per%C3%ABndim#sthash.ZGBSecPv.dpuf>